



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 163/4 prot.

Tiranë, më 30.12.2022

VENDIM
Nr.147, datë 30.12.2022

PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË ZBATIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 21, DATË 15.02.2022, NË INSTITUCIONIN
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike, Integritimit dhe Studimeve, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 21, dt. 15.02.2022, *“Mbi paralajmërimin e institucionit Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”*,

KONSTATOVA SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të nenit 65, germa “c”, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dispozitë e cila urdhëron përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për ata nëpunës të cilët kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, ka realizuar procesin e verifikimit lidhur me zbatimin e ligjit në këtë rast, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë.

Në këtë proces është përfshirë edhe institucioni i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, i cili pas kërkesës së Komisionerit për informacion, nëpërmjet shkresës nr. 3666/1 prot., datë 17.05.2021, ka raportuar në lidhje me punonjësit që plotësojnë moshën e pensionit të plotë të pleqërisë deri në fund të vitit kalendarik.

Pas përfundimit të verifikimit, Komisioneri ka dërguar pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, vendimin paralajmërues me Nr. 21, dt. 15.02.2022, *“Mbi paralajmërimin e institucionit Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”*, duke i lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës së konstatuar.

Në kuadër të procesit të mbikëqyrjes në vazhdim, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën nr. 3640/3 prot., datë 28.12.2022, ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues.

Duke analizuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, arrij në përfundimin se, nga ana e institucionit të mbikëqyrtur Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në vendim.

Konkretisht, ka përfunduar marrëdhënia në shërbimin civil për shkak të ligjit, për nëpunësen ***** në pozicionin e punës *“Specialiste, Sektori i Programeve të Zhvillimit në Fushën e Naftës, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Hidrokarbureve, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë”*, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 21, dt. 15.02.2022, *“Mbi paralajmërimin e institucionit Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Departamenti i Administratës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha